

UNMIK/RREG/2002/2
24.1.2002

RREGULLORJA NR. 2002/2

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/21 MBI DËSHMITARËT
BASHKËPUNUES**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë.

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/21 të datës 20 shtator 2001 mbi Dëshmitarët bashkëpunues,

Duke marrë parasysh nevojën për pengimin dhe luftimin e krimit në Kosovë,

Me anë të kësaj Rregulloreje ndryshohet neni 8 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/21 me qëllim të revidimit dhe sqarimit të mundësisë së zbatimit të saj:

Neni 1
Ndryshimi

Neni 8 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/21 do të ketë formulimin e mëposhtëm duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Kjo Rregullore do të vlejë gjithashtu edhe për procedurat penale të filluara ndërmjet datës 10.6.1999 dhe datës së hyrjes së saj në fuqi.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Regullore hyn në fuqi me 24.1.2002.

Charles Brayshaw,
Ushtrues i detyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm